




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës  
Republika Kosova- Opstine Suvareka  
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim*

<b>Nr-DATË/A:</b>	07Nr.339/350-26717 datë: 17.05.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	07Nr.350/26717 datë: 25.04.2023
<b>PËR/TO:</b>	<b>Point Construction Sh.p.k me përfaqësues Bajram Sopa Bukosh I - Suharekë</b>
<b>KOPJE/COPY:</b>	Drejtorinë e Inspeksionit, Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër Dosje të Drejtorisë Arkivin e Komunës
<b>NGA/FROM:</b>	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	<i>DREJTOR I DREJTORISË:</i> VISAR KUÇI
<b>LËNDA/SUBJECT:</b>	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/26717 datë: 25.04.2023 nga **Point Construction Sh.p.k me përfaqësues Bajram Sopa** nga Bukoshi I - Komuna Suahrekë, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e objektin me destinim Depo për bujqësi-Konstruksion metalik montazh PL me etazhitet P+0, në parcelën kadastrale 00638-0 ZK-Bukosh I, pronë e Sejdi Sopa sipas çertifikatës me numër referues 4080/2022 e datës 08.12.2022 sipas Kontratës mbi dhënjën me qira të paluajtshmërisë Nr.LRP.11828/2022 dhe Nr.Ref.2486/2022 të datës 19.07.2022 dhe në parcelën kadastrale 00636-3 ZK-Bukosh I, pronë e Tahir Sopa sipas çertifikatës me numër referues 1179/2023 e datës 13.03.2023 sipas Kontratës mbi dhënjën e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.3711/2023 dhe Nr.Ref.913/2023 të datës 14.03.2023. Parcelat ndërtimore të planifikuara me HZK jane Zonë Bujqësore-Zb me shfrytëzim të lejuar për kohësisht - Objekte për bujqësi. Andaj ky organ pas shqyrtimit të kërkesës ka vendosur si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj Shkrese.

- AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE

Laçe Buzatë



Data: 17.05.2023

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.339/350-26717

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim**

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrërimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM  
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<b>Point Construction Sh.p.k me përfaqësues Bajram Sopa</b>	Email :	
Adresa:	Bukosh I-Suharekë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-26717 datë:25.04.2023

Emri i Projektit:	Depo për bujqësi-konstruksion metalik montazh P+0
Emri i Projektuesit:	POINT construction
Adresa:	Prishtinë
Emaili:	.....

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIMI I RI, KATEGORIA I –Leje e përkohshme			
Adresa: Rr."Zaim Muqaj"-Bukosh I, Komuna Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Bukosh I	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikata me Nr.ref.4080-2022 datë 08.12.2022 pronë e Sejdi (Ramadan) Sopa si dhe çertifikatës me Nr.Ref.1179/2023 datë 13.03.2023 pronë e Tahir (Murat) Sopa.	00638-0 dhe 00636-3	Y= 7491392.454	X=4688189.689
		Y= 7491390.923	X=4688180.820
		Y= 7491412.602	X=4688177.079
		Y= 7491414.133	X=4688185.947

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Depo për bujqësi-Konstruksion metalik montazh			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Gabariti:	198 m <sup>2</sup>	Katshmëria:	P+0

faqe20245

<b>Vija rregullative:</b>	Nga aksi i profilin të rrugës regjionale "Zaim Muqa" 22.50m'	<b>Vija ndërtimore:</b>	Nga vija rregullative e rrugës regjionale "Zaim Muqa" 7.0m'
---------------------------	--	-------------------------	---

### Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore të përkohëshme **Point Construction Sh.p.k me përfaqësues Bajram Sopa** nga Bukosh I- Komuna Suahrekë i lejohet ndërtimi i objektit me destinim Depo për bujqësi-Konstruksion metalik montazh me etazhitet P+0. Kontratës mbi dhënjën me qira të paluajtshmerisë në afat prej 15 viteve konform kontratës Nr.LRP.11828/2022 dhe Nr.Ref.2486/2022 të datës 19.07.2022 për parcelën kadastrale me nr. 0638-0 dhe kontratës mbi dhënjën e paluajtshmerisë në shfrytëzim me kompensim në afat prej 5 viteve konform kontratës Nr.LRP.3711/2023 dhe Nr.Ref.913/2023 të datës 14.03.2023 për parcelën kadastrale me nr. 0636-3.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës 2022- 2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar parcelat kadastrale 00638-0 dhe 00636-3 është Zonë Bujqësore-Zb me shfrytëzim të lejuar bujqësi-Objekte për Bujqësi, sipas Projektit kryesor hartuar nga: "POINT Construction" SH.P.K Prishtinë.

Objekti ka karakter të perkohshem me leje në afat prej 5 viteve me etazhitet P+0 *(me mundësi vazhdimi)*. Ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUP e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhësë 198 m<sup>2</sup>.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

#### Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
  - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
  - Informata mbi Projektuesin.
  - Informata mbi Kontraktuesin.
  - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
  - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
  - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
  - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
  - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
  - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
  - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
  - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
  - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.

Lajmërimi

Shënim: Ky vendim është i detyrueshëm për të gjithë palët e interesuara dhe për të gjithë subjektet e biznesit që punojnë në këtë zonë.  
www.komuna-suahrek.com | Kontakt: 045/7200000 | Email: info@komuna-suahrek.com

Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
  - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
  - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.
  - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

#### A r s y e t i m

Aplikuesja **Point Construction Sh.p.k me përfaqësues Bajram Sopa** nga Bukosh I- Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/26717 datë: 25.04.2023, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Depo për bujqësi-Konstruksion metalik montazh me etazhitet P+0, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Akvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.282/350-17128 datë 14.04.2023 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.70/23, datës: 28.03.2023 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina “ EKOREGJIONI” Sh.a- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vertetimin e Ujësjiellit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren Nr. 42 datë: 30.03.2023.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.165 datë: 20.04.2023.
- Pëlqim parimor nga KEDS-SH.A, Nr.253, datë: 31.03.2023.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-49 datë 24.04.2023.
- Kordinatat e vendosjes se objektit sipas skicës së terrenit me numër të lëndës 01/2023 të datës 10.03.2023 të punuar nga gjeodeti i licensuar Valmir Krasniqi.
- Kontratat për dhënjen e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP. 3711/2023 dhe Nr.Ref. 913/2023 e datës 14.03.2023 dhe kontratës mbi dhënjen me qira të paluajtshmërisë Nr.LRP. 11828/2022 dhe Nr.Ref.2486/2022 e datës 19.07.2022.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues

Faqe 4 nga 5

- Njoftimin për pagesë (taksa administrative 475.20€) 07Nr.320/350-26717 datë 05.05.2023, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej **475.20€** dhe se për pagesën e kryer janë sjellë dëshmia nga BPB- Banka për Biznes Sh.a -Suharekë me datë 05.05.2023, sipas faturës komunale nr.001091 të datës 05.05.2023.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022- 2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

**Udhëzim juridik:** Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.


*Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë  
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr339/350-26717 datë:17.05.2023*

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- DSHPJK;
- Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUCI



faqe 5 nga 5